

**VENDIM**  
**Nr. 118, datë 1.12.2014**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “POWER ELEKTRIK SLLABINJE” SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe 13 pika 1, germa “d”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “g”; 5, pika 2; 8, 10/3; të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.12.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Power Elektrik Sllabinje” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se,

Aplikimi i shoqërisë “Power Elektrik Sllabinje” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm:

- Neni 9, pika 1

Formati i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 2

Dokumentacioni juridik, administrator dhe pronësor është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 3

Dokumentacioni financiar dhe fiskal është i plotësuar pjesërisht. (Mungon vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave.)

Të dhënat specifike sipas tipit të licencës për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

- Neni 9, pika 4/10, gjerat “a”, “b” dhe “c” janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Për dokumentacionet e munguara do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Power Elektrik Sllabinje” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit Ahmeti**